



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:061316
Datë: 29.01.2024
Numri i dokumentit: 05253102

C – IV. – 22 – 0130

Paditësi :

H V V nga Prishtina e përfaqësuar nga bashkëshortja e tij, A V nga Prishtina, e të cilin me autorizim e përfaqëson, av. B I nga Prishtina.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55 , Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi i pagave të pa paguara.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin Agron Hoxhaj, me dt.29.1.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, H V V nga Prishtina, e paraqitur kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) dhe Vendimi, PRN029 - 0177 i dt.10.06.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, **VËRTETOHET, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me dt.24.06.2014, paditësi, H V V nga Prishtina përmes av.B I nga Prishtina, i autorizuar i bashkëshortes së tij, A V nga Prishtina dhe atë përmes postës, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), ka parashtruar ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP), PRN029 - 0177 i dt.10.06.2015, e me të cilin, paditësit, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 4.600.00 € për periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2009 nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim).

Pala paditëse, parashtrësën e tij, e ka titulluar si "ankesë" mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron

si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për DhPGJSK-në e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësve me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesë apo ankesë.

Paditësi në padi në mes tjerash ka theksuar se ka themeluar marrëdhënien e punës me të paditurën që nga viti 1979 he këtë e dëshmon me të dhënat e Librezës së punës, se ai ishte i sistemuar si roje i objektit që nga 01.01.2007, se me dt. 25.01.2011, 46 punëtor të NSH, IMN Kosova” me seli në Prishtinë, kanë iniciuar procedurën gjyqësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë, se me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me dt.23 qershor 2014, ka filluar procedura e likuidimit të kësaj ndërmarrjeje dhe se pas këtij vendimi të Bordit të Drejtorëve të AKP-së për futjen e kësaj ndërmarrjeje në procesin e likuidimit të gjithë punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje iu është ndërprerë marrëdhënia e punës nga ana e AL-së të NSH, ”IMN Kosova” me seli në Prishtinë se me dt.31.07.2014, paditësi, ka parashtruar kërkesë në likuidim për kompensimin e pagave të pa paguara për 20 muaj në shumën prej 230.00 € prej viti 2007 deri 2009 në vlerë të përgjithshme prej 4,600.00 €, dhe se me dt.11.06.2015, AL-ja, ka lëshuar vendimin me anë të të cilit, i është refuzuar kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara mbi bazën se kërkesa e tij është parashtruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Tutje paditësi ka theksuar se AL-ja i NSH, ”IMN Kosova” nuk e ka kontestuar fare faktin se paditësi – ankuesi, ishte punëtor i NSH-së në fjalë, si dhe as lartësinë e kompensimit prandaj ka konsideruar të nevojshme të argumentoj lidhur me të ndërsa mbrojtjen ndaj kundërshtimeve tjera po e paraqet si më poshtë, se e paditura në mënyrë të gabuar, e ka zbatuar të drejtën materiale në atë mënyrë që fare nuk i ka zbatuar dispozitat të cilat e rregullojnë këtë gjendje faktike por AL-ja, ka bërë zbatimin e dispozitës ligjore të nenit 608 Ligjit të Punës së Bashkuar, e cila dispozitë ligjore por edhe vet ligj më tërësi, nuk parqet ligj të aplikueshëm në Kosovës që nga viti 1989, se ka cituar Ligjet gjegjëse të ish RSFJ-së, dhe se për këtë ka cekur Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Nr.04/L – 034), Ligjin për Ndërmarrjet të RSFJ-së (77/78) i Ndryshuar me dhe Plotësuar me Ligjet e RSGJ-së, nr.40/89 dhe 40/90 dhe 61/90, Ligji për Ndërmarrjet (GZ, nr.77/88) etj, se neni 196 i Ligjit për Ndërmarrjet (nr.77/78), ka përcaktuar se me hyrjen në fuqi të këtij ligji nuk zbatohen dispozitat e Ligjit për Punën e Bashkuar (GZ e RSFJ, Nr.53/76, nr.57/83 dhe nr.85/87, se Ligji për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për ndërmarrjet (nr.40/89), ka përcaktuar se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushon së zbatuari Ligji i Punës së Bashkuar përveç dispozitave nga Kapitulli IV dhe Kreu i VI kaptina 2 i këtij Ligji, se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Për Ndërmarrjet, ky ligj pushon së aplikuar, se me dt.14 prill 1989 në Gazetën Zyrtare të ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK), është shpallur Ligji mbi Marrëdhënien e Punës (teksti i spastruar) neni 73 i këtij ligj i cili përcakton se citojmë: “*Gjatë kohës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës që është shkaktuar pa fajin e punëtorit, punëtori gëzon të drejtën e shpërblimit të të ardhurave personale në lartësinë e përcaktuar me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës në pajtim me marrëveshjen vetëqeverisëse*”. Për më tepër neni 65 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, nr.24 të dt.22 qershor 1984), në mënyrë identike e rregullon çështjen e shpërblimit të të ardhurave personale të punëtorëve, se ankuesi e ka humbur vendimin e punës si pasojë e vendimit administrativ të nxjerr të Bordit të Drejtorëve të AKP-së për fillimin e procedurës së likuidimit, se praktika gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në 2 (dy) rast të përfaqësuar nga avokati i paditësit, ka marrë qëndrim se autoritetet përkatëse të likuidimit, në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale duke e bazuar vendimin e tyre në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, e cila dispozitë ligjore nuk paraqet ligj të aplikueshëm, se në Vendimin e ankimuar, AL-ja përkatëse, i është referuar edhe propozimit për përmbarrim të paraqitur na an e tij pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë e duke pretenduar se ky propozim nuk është miratuar sepse nuk është i bazuar në vendimin e formës së prerë, por është bërë në bazë të dokumentit të besueshëm, se fakti i dorëzimit të këtij propozimi për përmbarrim në Gjykatën Komunale në Prishtinë, dhe i cili është refuzuar me automatizëm, kualifikohet si padi për pagesën e pagave të pa paguara, sipas nenit

388 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/1978), si ligj i aplikueshëm në këtë çështje juridike sipas nenit 1057 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Nr.04/L -077, paraqet momentin e ndërprerjes së parashkrimit, si dhe i ka propozuar DhPGjSK-së që të merr aktgjykim e me të cilin të miratohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit dhe shfuqizohet Vendimi i AKP-së/AL-së të NSh, Industria e Materialit Ndërtimor, "IMN Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim), me nr. të protokollit, nr.5051/2015 i dt.11.06.2015, të obligohet e paditura, që paditësit, që në emër të kompensimit të pagave për ndërprerje jo ligjore të marrëdhënies së punës, të paguaj paditësit pagat e pa paguara për 20 muaj në lartësi të secilës pagë mujore prej 230.00 €, për periudhën kohore prej 2007 deri 2009, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 4,600.00 € si dhe të obligohet e paditura që të bëjë kompensimin e shpenzimeve për përfaqësim në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës për hartimin e kësaj ankesë në vlerë prej 104.00 euro si dhe të gjitha shpenzimet tjera deri në përfundim të procedurës e më gjerësisht si në këtë padi.

Paditësi, padisë/ankesës së tij, ia ka bashkangjitur provat: kopjen e librezës së punës, nr.5844, Urdhëresën e "Ital Kosova" të dt.31.12.2006, propozimin për përmbarrim të dt.25.01.2011 të bërë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kopjen e Regjistrimit të 46 punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë që kanë ushtruar propozimin për përmbarrim, kopjen e Vendimit të AKP-së për fillimin e likuidimit të NSh-së në fjalë, Kopjen e Vendimit të e kontestuar të AL-së, PRN029 - 0177 i dt.10.06.2015, kopjen e prokurës, dhe kopjen e ID-së së A V nga Prishtina.

Me dt.08.09.2017, e paditura, AKP me seli në Prishtinë, ka parashtruar mbrojtje ndaj padisë së paditësit të parashtruar kundër Vendimit të AL-së, PRN029-0177 i dt.10.06.2015, e duke pretenduar se AL-ja kur e ka refuzuar kërkesën e paditësit, është bazuar në atë se periudhën tre vjeçare të parashkrimit që është llogaritur nga qershori 2007, data kur paditës ka pretenduar se nuk është paguar nga ndërmarrja, ai nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim ligjor për të kërkuar pagat që pretendon se kanë mbetur të pa paguara, prandaj bazuar në nenin 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 dhe nenit 608 Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuar në GZ të RSFJ, Nr.53 të vitit 1976), kërkesa e tij i është refuzuar si e parashkruar, se propozimi për përmbarrim, E.nr.88/2011 nuk përmban vulën e pranimit nga gjykata, se e paditura i përmbahet qëndrimit se AL-ja, ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore, gjithashtu janë zbatuar saktësisht, se padia/ankesa e paditësit, është e pa pranueshme sepse objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin, Nr.04/L-034), paditësi nuk ka cekur se cili nen i Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, është shkelur nga AL-ja, se paditësi, nuk ka ofruar ndonjë argument ligjor në mbështetje të ankesës së tij dhe se në këtë mënyrë e ka shkelur nenin 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033 (ligji i mëhershëm) e që ka të bëjë me atë se çka duhet të përmbaj një ankesë, se e paditura, e ka kundërshtuar në tërësi bazën ligjore në të cilën është thirrur paditësi në ankesën e tij si dhe se kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme", pra nga neni 36 par.2.1 i Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 dhe neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar dhe i ka propozuar gjykatës që t'a refuzoj si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe t'a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L – 033.

Paditësi, me dt.28.09.2017, ka paraqitur përgjigje në mbrojtjen e të të paditurës e në të cilën ka theksuar se e vetmja çështje që vazhdon të jetë kontestuese në mes palëve edhe pas parashkrimit të mbrojtjes nga ana e AL/AKP-së, është çështja e ekzistimit ose mos ekzistimit të parashkrimit të kërkesës së paditësit, e duke u mbështetur në tërësi si në pohimet dhe argumentet e ngritura në ankesë ndaj vendimit të AL-së e më gjerësisht si në këtë përgjigje dhe se kësaj Përgjigje të dhënë në mbrojtjen e të të paditurës, ia ka bashkangjitur, provat : kopjen e propozimit për përmbarrim të dt.25.01.2011 të bërë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, dhe kopjen e Regjistrimit të 46 punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë që kanë

ushtruar propozimin për përmbarim.

Me dt.04.10.2017, e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë pas dërgimit të Përgjigjjes së paditësit të bërë ndaj mbrojtjes së paditurës të paraqitur në mbrojtjen – përgjigje në padit të të paditurës, ka paraqitur kundërpërgjigje në Përgjigjen e paditësit të bërë ndaj mbrojtjes – përgjigjes në padit

të të paditurës e në të cilën në mes tjerash ka theksuar se AL-ja në bazë të nenit 7 të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe nenit 23 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, paditësi ka detyrimin e dhe barrën e provës si dhe ka ngelur pranë qëndrimit se kërkesa e paditësit, është e parashkruar e më gjerësisht si në këtë kundërpërgjigje.

Me dt. 23. Mars 2022, DhPGJSK-ja me aktvendimin e saj, C – IV. – 15 – 1204 të dt.23.03.2022, ka ndërprerë procedurën për shkak të vdekjes së ankuesit e më gjerësisht si në këtë Aktvendim.

Me dt.04.04.2023, av. B I nga Prishtina, i autorizuari i bashkëshortes së paditësit, A V nga Prishtina, pranë kësaj gjykate, ka bërë propozimin për vazhdimin e procedurës së ndërprerë e që për objekt shqyrtimi e ka Vendimin, e Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN029 - 0177 i dt.10.06.2015 dhe se kësaj parashtrëse ia ka bashkangjitur, kopjen e noterizuar të aktvendimit për shqyrtimin e trashëgimisë, Nr.rendor 2268/2015, nr. të referencës 738/2015 të dt.29.04.2015 të noterit S V nga Podujeva e përmes së cilit provohet se i vetmja trashëgimtare ligjore e paditësit, tani i ndjerë është, A V nga Prishtina, bashkëshortja e tij.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 71 par.1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Në nenin 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, bëhet fjalë për paditësit dhe të paditurit, thuhet se: *“Paditës, në procedurën para Dhomës së Posaçme, është: personi që pretendon të drejta pronësie apo posedimi apo interesa të tillë mbi apo në një Ndërmarrje apo Korporatë, apo kapitalin e një Ndërmarrjeje apo Korporate; pasuritë në pronësi apo posedim të një Ndërmarrjeje apo Korporate ...”*.

Neni 76 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) që flet për palët, aty thuhet se: *“Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë ...”*.

Në nenin 253 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) që flet për përmbarjen e padisë, aty parasheh se: *“Padia duhet të përmbajë: a) kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore; b) faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën; c) provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla; d) vlerën e kontestit; e) bazën juridike dhe f) të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë (neni 99 i këtij ligji)”*.

Po ashtu në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e

vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, si dhe sipas detyrës zyrtare, gjykata, ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit, H V V nga Prishtina e të cilin e përfaqëson, bashkëshortja e tij, A V nga Prishtina, duhet të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i kontestuar i Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN029 - 0177 i dt.10.06.2015, duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.23.03.2014, dhe se paditësi në procedurën e likuidimit tek AL-ja me dt.31.07.2014, pra brenda afatit ligjor administrativ para AKP-në, e ka paraqitur, përmes të autorizuarit të bashkëshortes së tij, kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 4.600.00 € për periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2009 nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim) por e cila kërkesë është refuzuar me Vendimin, PRN029 - 0177 i dt.10.06.2015 të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së derisa paditësi, pas pranimit të këtij aktvendimi në procedurën e likuidimit pas dt.11.06.2014, ankesën kundër Vendimit të kontestuar të AL-së, PRN029 - 0177 i dt.10.06.2015, pranë DhGJSK-së, e ka paraqitur me dt.24.06.2014 dhe atë përmes dërgimit me postë, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve për paraqitjen e saj dhe se kërkesës/padisë së tij, paditësi, ia ka bashkangjitur edhe Vendimin e kontestuar të AL-së, PRN029 - 0177 i dt.10.06.2015.

Gjykata, pra vlerëson se padia/kërkesa e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe të afatshmërisë nga nenin 36 lidhur me nenin 33, 35, dhe nenit 74 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në.

Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata vlerësoj se nuk është çështje kontestuese fakti se paditësi ka qenë marrëdhënie të punës tek Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim) por si çështje kontestuese, na paraqitet çështje se trashëgimtarja ligjore e paditësit a ka bazë ligjore që të kërkoj kompensimin e pagave të pa paguara në shumën e lartë nga NSH-ja në fjalë, pra në rastin konkret, bashkëshortja e tij pra ajo a ka legjitimacion aktiv për të kërkuar kompensimin në fjalë sepse pala paditëse, pas nxjerrjes së Vendimit të AL-së, PRN029 - 0177 i dt.10.06.2015, dhe në kohën e marrjes së këtij aktgjykimi, ka vdekur kurse ankesën kundër këtij vendimi, pranë DhPGJSK-së, e ka bërë, av. B I nga Prishtina, i autorizuar i A V nga Prishtina, bashkëshortes së e tij i paditësit, H V V nga Prishtina derisa përkitazi me pretendimin e të të paditurës së bërë në arsyetimin e vendimit kontestuar të AL-së si dhe në mbrojtjen e të paditurës së bërë në ankesën/padinë e paditësit, se kërkesa e tij, është e parashkruar, e mori për bazë ndërsa kërkesa e paditësit në Autoritetin e Likuidimit (AL), është parashtruar brenda afatit ligjor pra me dt.31.07.2014 kurse në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGKSK), është parashtruar ankesë me dt.24.06.2015 dhe atë kundër Vendimit të AL-së, PRN029 - 0177 të dt.10.06.2015 të AL-së për Ndërmarrjen Shoqërore, (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim) e me të cilin, paditësit, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa në fjalë e dhe atë për shkak të parashkrimit e duke u bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar sepse paditësi, në periudhën tre vjeçare të parashkrimit që është llogaritur nga qershori i vitit 2007, pra data kur paditësi ka pretenduar se nuk është paguar nga ndërmarrja, ai nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim ligjor për të kërkuar pagat që pretendon se kanë mbetur të pa paguara.

Në nenin 6 të Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të Agjencisë, aty thuhet se :”*Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2. ...*” derisa në nenin 40 par.1 pika 7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në që flet për prioritetet e kërkesave dhe interesave, aty thuhet se : *Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë*”. Në nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/2007 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës, që flet për Shkëputjen e kontratës së punës për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje, është paraparë se : ... *Kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje. ... (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore; (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore; (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore; (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore; (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore*”. Po ashtu në nenin 76 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, që flet për Largimet kolektive nga puna, aty parashihet se :”*Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas nën-paragrafit 1.1. të paragrafit 1 të nenit 70, të këtij ligji ku përfshihen së paku 10% e të të punësuarave por jo me pak se njëzet (20) të punësuar, të larguar brenda intervalit kohor prej gjashtë (6) muajsh, konsiderohet si largim kolektiv nga puna; 2. Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna, zbatohen dispozitat nga paragrafi 3. i këtij neni. 3. ... Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle: 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore; 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore; 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore; 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetënëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore; dhe 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore*”.

Për çështjen e pagesës së pagave për të një punësuar në një ndërmarrje, në nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës), ka qenë e paraparë se : “*Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës*” kurse në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : “*I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...*”.

Në bazë të nenit 31 par.1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktohet se:”*Palët, në parashtresat e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës*” kurse në nenin 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se “*... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*” derisa në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 për Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: “*Pagesa e shumë s të pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkese tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet*” e për më tepër edhe në nenin 137 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i vitit 1978 gjithashtu, parashihet afati i njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Në nenin 42 par.2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme , parashihet se : *''Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Secilës palë tjetër do t'i jepet mundësia e arsyeshme për ta kontestuar legjitimitetin apo saktësinë e provave të tilla, nëpërmjet paraqitjes së parashtrësave apo provave tjera (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) me anë të së cilave synohet përgënjeshtrimi i legjitimitetit apo saktësisë së provave të tilla. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë''.*

Po ashtu sipas nenit 7 par.1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *''Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla''.*

Përkizati me çështjen e vdekjes së një pale, si në rastin konkret, në nenin 359 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr.GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978, parashihet se: *''Me vdekjen e debitorit ose të kreditorit pushon detyrimi vetëm në qoftë se ka lindur duke marrë parasysh veçoritë personale të njerës nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit''* ndërsa edhe në nenin 340 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Nr. 04/L-077 të dt.10 maj 2012, që flet për vdekjen e një pale, aty thuhet se : *''Me vdekjen e debitorit ose të kreditorit shuhet detyrimi vetëm në qoftë se është krijuar duke marrë parasysh veçoritë personale të njëjës nga palët kontraktuese ose aftësitë personale të debitorit''.* Duke qenë se pala paditëse edhe pse ka paraqitur disa prova para kësaj gjykate vendimmarëse, të njëjta prova e veçmas propozimin për përmbarrim të vitit 2011 mirëpo kjo gjykatë këtë propozim, nuk e konsideroj si fakt të ndërprerjes së afatit të parashkrimit nga neni gjegjës i LMD-së me arsyetimin se bërja e këtij propozimi në vitin 2011, nuk ka ndikim në vendimarrje tjetër të kësaj gjykate derisa nuk është i bazuar edhe pretendimi i paditësit se Ligji i Punës së bashkuar, nuk është ligj i aplikueshëm pasi që me Ligjin për Ndërmarrje me Ndryshimet dhe plotësimet tij, nuk i ka sh'fuqizuar në tërësi dispozitat e këtij ligj e veçmas nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, që i referohet afatit të parashkrimit dhe i cili është ligj ende në fuqi sipas nenit 1 të Rregullorës së UNMIK-ut, Nr.1999/24 por edhe propozimi për vazhdimin e procedurës së ndërprerë e të cilit, av. B I nga Prishtina, ia ka bashkangjitur kopjen e noterizuar të aktvendimit për shqyrtimin e trashëgimisë, Nr.rendor 2268/2015, nr. të referencës 738/2015 të dt.29.04.2015 të noterit S V nga Podujeva e përmes së cilit provohet se i vetmja trashëgimtare ligjore e paditësit, tani i ndjerë është, A V nga Prishtina, bashkëshortja e tij prapë se prapë këto prova nuk kanë ndikim në kërkesën e paraqitur për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 4.600.00 € për periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2009 nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim) si dhe se meqë pala paditëse, ka vdekur, me dt.30.06.2014 në Prishtinë, kërkesa e natyrës së tillë, nuk mund të jetë e bartshme tek trashëgimtarët e paditësit, tani i ndjerë sepse e njëjta kërkesë lidhet me *veçoritë personale të paditësit dhe aftësitë personale të tij*, gjykata vije në përfundim se, kërkesëpadinë e palës paditëse, është e pabazuar.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.

Gjykata vlerëson se pretendimin e të paditurës, AKP-së, se kërkesa e paditësit, është bërë pas kalimit të afati prej 3 (tre) vjetëve dhe atë në kuptim të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në, dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, e mori për bazë të trajtimit të çështjes edhe pse paditësi me kohë (me dt.02.10.2013), ka bërë kërkesën në procedurën e likuidimit pranë AL-së e për realizimin e pagave të pa paguara në shumën prej 4.600.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim) si dhe pranë DhPGJSK-së por edhe pse i njëjti, si palë paditëse, përmes trashëgimtares së tij, e

në këtë rast, A V nga Prishtina në procedurën para DhPGJSK-së, ka ofruar disa prova në mbështetje të kërkesës së tij për pagat e pa paguara në shumën e pretenduar nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim) por pa u specifikuar periudha kohore për këto paga të pa paguara, prapë se prapë, kjo kërkesë është e pabazuar pas vdekjes së paditësit, trashëgimtarja e tij, e në këtë rast, A V nga Prishtina, nuk ka legjitimacion aktiv që të jetë palë në procedurë dhe nuk ka të drejtë që të kërkojnë këtë kompensim sepse kërkesat e kësaj natyre juridike, lidhen me personalitetin e paditësit, H V nga Prishtina, tani i ndjerë dhe të njëjtat nuk mund të barten tek familjarët e tij, andaj pasi gjykata, që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, por edhe sipas detyrës zyrtare, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadia e paditësit, H V nga Prishtina, i përfaqësuar nga bashkëshortja e tij, A V nga Prishtina për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 4.600.00 € për periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2009 nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "IMN Kosova" me seli në Prishtinë (në likuidim), është e pabazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet si e pa bazuar kurse Vendimi, PRN029 - 0177 i dt.10.06.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të jap arsyetime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), gjykata, vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2023:061316, 29.01.2024

**Gjykatësi,
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).